



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 1/2019 (JD)
Datë 19.12.2019

Vendim nr. 1 (JD)
Datë 20.07.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji i Posaçëm i Apelimit i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Natasha Mulaj	Kryetare e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit
Albana Shtylla	Anëtare e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit
Ardian Hajdari	Anëtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit
Ina Rama	Anëtare e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit
Luan Daci	Anëtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit
Rezarta Schuetz	Anëtare e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit
Sokol Çomo	Anëtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

– mori në shqyrtim në seancë plenare publike, më datë 20.07.2020, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 1/2019, datë 19.12.2019, që i përket:

KËRKUES: Tom Dedaj.

SUBJEKTET
E INTERESUARA:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përfaqësuar nga z. E. S. dhe z. A. Sh., sipas autorizimit nr. {***} prot., datë 03.07.2020, të kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
Prokuroria e Përgjithshme, e përfaqësuar nga znj. K. M., sipas autorizimit nr. {***} prot., datë 11.02.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm.

OBJEKTI: - Shfuqizimi i vendimit nr. {***}, datë 28.01.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për shkarkimin nga detyra të prokurorit Tom Dedaj.

- Kthimi në detyrën e mëparshme të prokurorit, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër.
- Dhënia e pagës nga data 28.01.2019 e në vazhdim.
- Pezullimi i vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë deri në përfundimin e gjykimit të kësaj çështjeje.

BAZA LIGJORE:

Nenet 6, 7, 15, 16, 17, 18, 23, 30, 32 33, 42, 43, 44, 148/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 31 e vijues, neni 153 e vijues i Kodit të Procedurës Civile; neni 462 i Kodit të Procedurës Penale; neni 59 i Kodit Penal; Kodi i Punës; neni 1 e vijues, nenet 9 deri 16, nenet 18, 20, 22, 44, 46, 47, 49, 51, 55, 56, 58, 60, 61, 80, 81, 82, 83, 85, 93, 105, 108, 115, 116, 118, 121 e vijues, neni 125 e vijues i Kodit të Procedurës Administrative; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; neni 1 e vijues, 26 e vijues, 34 e vijues i ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 1 e vijues, 111, 115 e vijues, 118 e vijues, 157, 160, 161, 164, 166, 169, 172, 173, 174 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.04.2017 dhe nr. 75, datë 19.04.2002; vendimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë i datës 22.09.2012, “Rrapo kundër Shqipërisë”; vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 03.01.2014.

KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Natasha Mulaj, përfaqësuesin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe përfaqësuesin e Prokurorisë së Përgjithshme që kërkuan vazhdimin e gjykimit në mungesë dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Në ngarkim të kërkuesit Tom Dedaj, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, nisur nga emisioni “{***}” i televizionit “{***}”, ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë 24.10.2016, për veprën penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.
2. Prokurori i Përgjithshëm, me urdhrin nr. {***}, datë 31.10.2016, ka vendosur pezullimin e kërkuesit Tom Dedaj nga detyra, deri në përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***}, datë 24.10.2016.

3. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me vendimin nr. {***}, datë 26.07.2018, vendosi:
 - Deklarimin fajtor të të pandehurit Tom Dedaj për kryerjen e veprës penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.
 - Në aplikim të nenit 30, pika 1, nenit 35, nenit 44, pika 2 e Kodit Penal, dhënien e një dënimi për heqjen e së drejtës për të pandehurin Tom Dedaj për të ushtruar funksione publike për 5 (pesë) vjet.
 - Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin Tom Dedaj dhe vënien në provë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me kushtin që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale. Ky afat fillon nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi [...].
4. Kundër vendimit nr. {***}, datë 26.07.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, ka bërë ankim i pandehuri Tom Dedaj, në të cilin ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi, deklarimin e pafajshëm të tij për veprën penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, bazuar në nenin 388, pika 1/ “a” e Kodit të Procedurave Penale, pasi fakti nuk ekziston ose nuk provohet se ekziston.
5. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 06.11.2018, vendosi:
 1. Lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 26.07.2018, të Gjykatës së Krimeve të Rënda Tiranë, në lidhje me të pandehurin F. (F.) Z..
 2. Ndryshimin e këtij vendimi si më poshtë:
 - Deklarimin fajtor të të pandehurit Tom Dedaj për kryerjen e veprës penale “Moskallëzim të krimit”, të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.
 - Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin Tom Dedaj dhe vënien në provë për një periudhë prej 2 (dy) vjetësh, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë ndonjë vepër tjetër penale.
[...]
 - Në bazë të nenit 35/2, 30/1 dhe 44/2 të Kodit Penal, ndaj të pandehurit Tom Dedaj jepet një dënim plotësues “Heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për një kohë prej një viti” [...].
6. Referuar vendimeve të mësipërme dhe urdhrin të prokurorit, datë 24.12.2018, “Për ekzekutimin e vendimit penal nr. {***}, datë 06.11.2018, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, për të dënuarin Tom Dedaj”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. {***}, datë 28.01.2019, “Për shkarkimin nga detyra të prokurorit”, vendosi shkarkimin e prokurorit Tom Dedaj.
7. Duke mos qenë dakord me këtë vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Tom Dedaj e ka bërë çështjen konflikt gjyqësor, duke iu drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Apelit Administrativ.

I. SHQYRTIMI I ÇËSHTJES NGA GJYKATA E APELIT ADMINISTRATIV

8. Kërkuesi Tom Dedaj i është drejtuar Gjykatës së Apelit Administrativ, me anë të kërkesëpadisë me objekt:
 1. shfuqizimin e vendimit për shkarkimin nga detyra të prokurorit Tom Dedaj;
 2. kthimin në detyrën e mëparshme të prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër;

3. dhënien e pagës nga data 28.01.2019 e në vazhdim;
4. dhënien e një shpërblimi të drejtë në shumën 30.000.000 (tridhjetë milionë) lekë;
5. konstatimin e diskriminimit ndaj paditësit Tom Dedaj;
6. anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19.12.2018, për sa i përket certifikimit, dhënies së mandatit si anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë të anëtarëve: G. I., T. B., B. Sh., A. D., A. S., B. C., G. O. dhe N. S.;
7. anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19.12.2018, për sa i përket konstituimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
8. pezullimin e vazhdimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë deri në përfundimin e procesit gjyqësor;
9. pezullimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë deri në përfundimin e gjykimit të kësaj çështje –

me palë të paditura, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë.

Bashkë me padinë, kërkuesi ka parashtruar edhe kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të padisë nëpërmjet pezullimit të ekzekutimit të vendimit nr. {***}, datë 28.01.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, deri në përfundimin e gjykimit të kësaj çështjeje.

9. Në pretendimet e ngritura pranë Gjykatës së Apelit Administrativ, kërkuesi Tom Dedaj ndër të tjera argumenton se:
 - Vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është absolutisht i pavlefshëm si në formë, ashtu dhe në përmbajtje. Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk ka kompetencë për ta shkarkuar paditësin nga detyra dhe baza ligjore e përdorur për shkarkimin e tij është neni 148/d, pika 2, germa “b” e Kushtetutës së Shqipërisë, ndërkohë që pretendon se ndaj tij nuk rezulton të jetë zhvilluar një proces disiplinor.
 - Vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është marrë në shkelje të Kushtetutës, pasi e ka bazuar vendimmarrjen e tij në Kushtetutë, duke marrë kështu atributet e Gjykatës Kushtetuese. Paditësi pretendon se ndaj tij nuk është aplikuar një proces disiplinor as nga Prokurori i Përgjithshëm dhe as nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, i cili nuk ekziston, pasi nuk është emëruar ende.
 - Pezullimi nga detyra mbi bazën e urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. {***}, datë 31.10.2016, është bërë bazuar në nenin 26, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë”, i ndryshuar, i cili përcakton se: “Prokurori mund të pezullohet në ushtrimin e detyrës me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm në rastet kur: a) ndaj tij vendoset nisja e procedimit penal deri në përfundimin e procedimit. Në rastin konkret, procedimi penal akoma nuk ka përfunduar.
 - Nuk është filluar në mënyrën e përcaktuar me ligj një procedim disiplinor ndaj paditësit, pasi nuk ka asnjë urdhër apo shpresë që të ketë shënuar fillimin e këtij procedimi, si dhe nuk i është dhënë ndonjë akt, vendim apo material paraprak lidhur me fillimin e procedimit.
 - Nuk është thirrur sipas Kushtetutës e ligjit për t’u paraqitur e për t’u dëgjuar para Këshillit.
 - Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk është një institucion funksional, pasi nuk ka seli, nuk ka ligj ekzistent e nuk ka një rregullore si duhet të funksionojë.

- Vendimi nr. {***}, datë 28.01.2019, është i pavlefshëm si në formë, ashtu dhe në përmbajtje, pasi mungon paraqitja e faktit dhe mënyra e ankimit, organi apo gjykata se ku ankimohet, si dhe afati kohor i ankimit.
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit”, konkretisht me nenin 25 “Siguria dhe shëndeti në punë”.
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk është kompetent për të shqyrtuar këtë çështje, pasi ligji nr. 96/2016, i sipërcituar, vepron vetëm për ata gjyqtarë e prokurorë të cilët e kalojnë procesin *vetting*, të cilin Tom Dedaj nuk e ka kaluar.
- Argumenti se është dënuar me vendim të formës së prerë nuk qëndron, pasi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kundër këtij vendimi, duke referuar në vendimin unifikues nr. 2, datë 3.11.2014 të kësaj gjykate, që trajton konceptin e vendimit të formës së prerë. Sipas paditësit, çështja duhet shtruar për diskutim e shqyrtim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë jo vetëm se është detyrim kushtetues e ligjor, por edhe për faktin se, siç del nga vendimi i gjykatës të cilit i referohet Këshilli, Tom Dedaj është dënuar me kusht, që do të thotë që i jepet një personi që nuk paraqet rrezikshmëri. Së dyti, paditësi Tom Dedaj nuk mund të qëndrojë në periudhën e provës në të cilën ndodhet aktualisht, pasi me vendimin e marrë, është dënuar maksimalisht dhe qëndrimi në këtë status nuk ka më asnjë vlerë.
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk duhet të kishte marrë një vendim përfundimtar, duke qenë se vendimi i Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda nuk është përfundimtar dhe i formës së prerë, si dhe nuk ndodhemi përpara faktit të gjësë së gjykuar.
- Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë kanë qenë në konflikt të hapur interesi dhe nuk kanë pasur të drejtë të marrin pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje.
- Paditësi konstaton se vendimi nr. {***}, datë 28.01.2019, për shkarkimin e tij, është marrë 6 muaj e 2 ditë pas vendimit nr. {***}, datë 27.07.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, argument bazuar në nenin 462 të Kodit të Procedurës Penale.
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organ kushtetues, duhet të shqyrtonte çështjen në tërësi, pa asnjë kufizim, pasi sipas paditësit ndaj tij janë kryer veprime të kundërligjshme nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Dibër, Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda.
- Nga veprimi i kundërligjshëm i Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, paditësit i është shkaktuar dëm i jashtëzakonshëm moral dhe shëndetësor.
- Paditësi vlerëson se vendimi i dhënë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë është i padrejtë, pasi në vendimmarrjen për shkarkimin e tij, kanë marrë pjesë prokurorë të cilët nuk kanë kaluar akoma procesin *e rivlerësimit*, aq më keq kur për njërin prej anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ishte vendosur shkarkimi nga detyra me vendim të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
- Vendimi nr. {***}, datë 28.01.2019, është marrë në kundërshtim me nenin 42, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe me nenin 6 të KEDNJ¹-së, pasi nuk ishte zhvilluar një proces i rregullt ligjor.

¹ KEDNj – akronim për “Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

- Gjykata e Apelit Administrativ është kompetente për të gjykuar këtë çështje bazuar në nenin 34 të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 192/1 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 171 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.
 - Ky rast është trajtuar si shkelje ligjore, pasi është pezulluar nga detyra me vendimin nr. {***}, datë 01.11.2016, të ish-Prokurorit të Përgjithshëm, i cili shënon datën e fillimit të një hetimi disiplinor apo procedimit disiplinor, pra akti është nxjerrë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, datë 10.11.2016.
10. Gjatë shqyrtimit të çështjes administrative nr. {***} akti, datë 22.02.2019, në Gjykatën e Apelit Administrativ, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Prokuroria e Përgjithshme në cilësinë e palës së paditur në këtë proces, kanë kërkuar shpalljen e moskompetencës lëndore të kësaj gjykate dhe dërgimin e akteve në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, duke e bazuar kërkesën e tyre në argumentet e mëposhtme.
- Vendimi nr. {***}, datë 28.01.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për shkarkimin nga detyra të kërkuesit Tom Dedaj, është mbështetur në nenin 148/d, pika 2, germa “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon përgjegjësinë disiplinore për prokurorët dhe rastet kur ata shkarkohen nga detyra.
 - Neni 192, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikon se: *Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, ndaj aktit administrativ individual të Këshillit, mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ. Aktet administrative individuale që vendosin masë disiplinore mbi prokurorët, ankimohen në Gjykatën Kushtetuese.*
 - Sipas parashikimeve të nenit 179, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: *Gjatë mandatit të tyre 9- (nëntë) vjeçar, gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.*
 - Në vijim të këtij parashikimi kushtetues, ligji specifik nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 5, pika 3 e tij parashikon: *Kolegji i Apelimit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjisllacionin që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë:*
 - a) *shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;*

b) *ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.*

11. Gjykata e Apelit Administrativ, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, me vendimin nr. {***}, datë 22.10.2019, ka vendosur:
 - *Shpalljen e moskompetencës funksionale të Gjykatës së Apelit Administrativ për shqyrtimin e pikave 1, 2, 3 dhe 9 të objektit të kërkesëpadisë së paditësit Tom Dedaj dhe dërgimin e akteve Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*
 - *Shpalljen e moskompetencës funksionale të Gjykatës së Apelit Administrativ për shqyrtimin e pikave 4, 5, 6, 7 dhe 8 të objektit të kërkesëpadisë së paditësit Tom Dedaj dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*
 - *Ky vendim është i ankimueshëm së bashku me vendimin përfundimtar.*
 - *Urdhërohet sekretaria e Gjykatës së Apelit Administrativ të marrë masa për dërgimin e akteve respektive Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.*
12. Gjykata e Apelit Administrativ, për shpalljen e moskompetencës funksionale dhe dërgimin e akteve Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, arsyeton se vendimi nr. {***}, datë 28.01.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është bazuar në nenin 148/d, pika 2, germa “b” e Kushtetutës, që përcakton se Këshilli i Lartë i Prokurorisë shkarkon prokurorin nëse dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Shkarkimi nga detyra i magjistratit është parashikuar në nenin 105 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si një nga llojet e masave disiplinore që Këshilli i Lartë i Prokurorisë mund të marrë. Po kështu, sipas përcaktimeve të nenit 111 të po këtij ligji, është përcaktuar si rast për shkarkim të magjistratit dhe dënimi për kryerjen e një krimi. Gjykata e Apelit Administrativ, në mbështetje të nenit 179/7 të Kushtetutës dhe nenit 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arsyeton se Kolegji i Posaçëm i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj prokurorëve, njëson me masë disiplinore dënimin me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi dhe, për rrjedhojë, shkarkimin nga detyra të prokurorit Tom Dedaj.
13. Kundër vendimit nr. {***}, datë 22.10.2019, të Gjykatës së Apelit Administrativ, është ushtruar rekurs nga kërkuesi.
14. Gjykata e Apelit Administrativ, me vendimin e datës 17.12.2019, bazuar në nenin 13, pika 3 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, që parashikon se: *Gjykata shpall me vendim moskompetencën e saj për shkaqet e parashikuara në këtë nen dhe urdhëron dërgimin e akteve gjykatës kompetente. Vendimi për shpalljen e moskompetencës dhe vendimi për rrëzimin e kërkesës për shpalljen e moskompetencës ankimohen së bashku me vendimin përfundimtar – ka vendosur mospranimin e rekursit kundër vendimit nr. {***}, datë 22.10.2019, të Gjykatës së Apelit Administrativ.*

II. SHQYRTIMI I ÇËSHTJES NGA KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

15. Kolegji i Posaçëm i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese është vënë në lëvizje nga Gjykata e Apelit Administrativ, e cila ka dërguar aktet e çështjes gjyqësore, të protokolluara në Kolegji me nr. {***} prot., datë 19.12.2019.
16. Në Kolegjin e Posaçëm të Apelit është regjistruar çështja nr. 1/2019 që i përket juridiksionit disiplinor, me kërkues Tom Dedaj dhe subjekte të interesuara Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Prokuroria e Përgjithshme.
17. Kolegji i shqyrtimit paraprak pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pasi analizoi bazën ligjore të zbatueshme lidhur me gjykimin e çështjes nr. 1/2019 në kuadër të Juridiksionit Disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, konstaton se:
 - i) Juridiksioni Disiplinor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit është një juridiksion kushtetues, i cili do të shoqërojë veprimtarinë e tij gjatë mandatit 9- (nëntë) vjeçar, sipas parashikimeve të nenit 179, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon: *Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.*
 - ii) Në vijim të këtij parashikimi kushtetues, neni 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i përcakton Kolegjit të Posaçëm të Apelit bazën ligjore, sipas së cilës ai do të funksionojë dhe do të procedojë gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues që lidhet me Juridiksionin Disiplinor: “[...] Kolegji i Apelit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjisllacionin që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë:
 - a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
 - b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë”.
 - iii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në vendimin nr. {***}, datë 28.01.2019, për shkarkimin nga detyra të prokurorit Tom Dedaj, është bazuar në nenin 148/d, pika 2, germa “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon:
 2. Prokurori shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë kur:
 - a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës;

- b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.*
- iv) Sipas parashikimit të pikës 3 të nenit 148/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë – *Kundër vendimit të shkarkimit bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese* – arrihet në përfundimin se kundër vendimeve të shkarkimit të marra nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për shkak të një vendimi gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi, bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese.
- v) Në nenin 105 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, renditen llojet e masave disiplinore të cilat aplikohen nga këshillat, që janë: a) vërejtje konfidenciale; b) vërejtje publike; c) ulje e përkohshme e pagës; ç) ulje në detyrë nga një pozicion më i lartë në një më të ulët ose nga një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm ose në një prokurori tjetër; d) pezullim nga detyra për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, me të drejtë për përfitimin e pagës minimale, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave; dh) *shkarkim nga detyra.*

Ndërsa neni 111 i këtij ligji, që zbërthen më tej shkarkimin nga detyra si masë disiplinore, parashikon: *1. Shkarkimi i magjistratit nga detyra jepet si masë disiplinore vetëm në këto raste: a) kur shkëlja është shumë e rëndë; b) kur Këshilli çmon se natyra dhe rrethanat e kryerjes së shkëljes e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm ose të padenjë për të ushtruar funksionin e tij, për shkak të dënimit për kryerjen e një krimi, për shkak të paaftësisë së rëndë dhe të dukshme, ose për shkak të një sjelljeje që kryhet të paktën me pakujdesi të rëndë, sipas nenit 101, shkronja “b” e këtij ligji, dhe që shkel haptazi vlerat themelore të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë.*

Nisur nga sa më sipër, si dhe nga parashikimi i nenit 192, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, që përcakton se: *Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit. Aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi prokurorët ankimohen në Gjykatën Kushtetuese*, arrihet në përfundimin se Kolegji i Posaçëm i Apelit është gjykata kompetente që shqyrton ankimet ndaj vendimeve të këshillave për marrjen e masave disiplinore ndaj magjistratëve.

18. Kolegji i shqyrtimit paraprak, pasi analizoi aktet e dosjes gjyqësore të çështjes nr. 1/2019, datë 19.12.2019, që i përket Juridiksionit Disiplinor, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 22 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për shkarkimin nga detyra të prokurorit Tom Dedaj, si një akt administrativ individual që vendos masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, në referim të nenit 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 31, pika 3 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, ku parashikohet: *[...] Në të gjitha rastet, kur ndonjë nga gjyqtarët e Kolegjit nuk është i një mendimi me të tjerët, kërkesa i kalon për shqyrtim paraprak Mbledhjes së Gjyqtarëve, me vendimin nr. 1/1, datë 03.02.2020, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak Mbledhjes së Gjyqtarëve.*

19. Mbledhja e Gjyqtarëve, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur, vëren se ajo përmban shkakun dhe bazën ligjore për shqyrtim gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe është në kompetencë të kësaj gjykate. Në bazë të nenit 21, pika 1 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, në mbledhjen e datës 07.02.2020 vendosi: *Kalimin për shqyrtim në seancë plenare publike të kërkesës së kërkuarit Tom Dedaj.*
20. Në zbatim të nenit 134, pika 1, germa “i” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që parashikon se: *Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: [...] individëve*, dhe nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike kishte për qëllim të verifikonte së pari vullnetin e kërkuarit Tom Dedaj për vijimin e shqyrtimit të çështjes së tij nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, si kolegji pranë Gjykatës Kushtetuese, meqenëse kërkimi i tij në aspektin formal i është drejtuar Gjykatës së Apelit Administrativ dhe jo drejtpërdrejt Kolegjit, sipas parashikimit të rregullit të cituar më lart. Në vëmendje të Kolegjit, lidhur me legjitimitin e z. Tom Dedaj në cilësinë e kërkuarit në këtë proces, ishte edhe fakti se z. Tom Dedaj, pasi është vënë në dijeni që çështja gjyqësore e tij ka kaluar për kompetencë në Kolegji që me dhënien e vendimit nr. 229, datë 22.10.2019, të Gjykatës së Apelit Administrativ, për të cilën kërkuari ka bërë rekurs ndaj vendimit, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të sipërcituar dhe gjykimin e çështjes po nga Gjykata e Apelit Administrativ, por me një tjetër trup gjykues dhe vazhdimin e gjyqimit të kësaj çështjeje. Për të gjitha këto rrethana, Kolegji çmoi se verifikimi i vullnetit të z. Tom Dedaj për të adresuar kërkimin e tij kundër vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë që ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe paraqitja e këtij vullneti në formën e duhur ligjore, do të duhej të ishin veprimet e para që do të verifikoheshin e analizoheshin prej Kolegjit, para se të fillonte shqyrtimi gjyqësor i çështjes, si parakushte që legjitimonin Kolegjin në ushtrimin e juridiksionit të tij në rastin konkret.
21. Në kuadër të informimit dhe transparencës të veprimtarisë së Kolegjit, nga momenti i regjistrimit të kësaj çështjeje të juridiksionit disiplinor, u publikuan në faqen zyrtare në internet të Kolegjit të dhënat e çështjes, palët e interesuara, përbërja e kolegjit të shqyrtimit paraprak të kërkesës, data e zhvillimit të seancës publike, statusi i procedurës së çështjes etj.
22. Kolegji i Posaçëm i Apelit, me shkresën nr. {***} regj., datë 07.02.2020, njoftoi kërkuarin Tom Dedaj se do të gjykojë më datë 24.03.2020, ora 10:00, në seancë plenare publike, kërkesën kundër vendimit nr. 22, datë 28.01.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë që ka vendosur:
*1. Shkarkimin nga detyra të prokurorit Tom Dedaj, bazuar në vendimin e formës së prerë nr. {***}, datë 06.11.2018, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë [...].*
23. Me vendimin nr. 06, datë 11.03.2020, Kolegji i Posaçëm i Apelit, për shkak të situatës së krijuar nga përhapja e virusit COVID-19 në vend dhe në kuadër të masave mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar prej tij, vendosi të shtyjë deri në një njoftim të dytë seancën

gjqësore publike që i përket çështjes (JD) nr. 1/2019, me kërkues Tom Dedaj, caktuar për t'u zhvilluar ditën e martë, datë 24.03.2020, ora 10:00.

24. Kolegji i Posaçëm i Apelit, me shkresën nr. {***} regj., datë 19.06.2020, njoftoi kërkuesin për zhvillimin e seancës gjyqësore publike më datë 20.07.2020, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
25. Seanca gjyqësore u zhvillua më datë 20.07.2020, ora 10:00. Nga verifikimi i paraqitjes së pjesëmarrësve dhe përfaqësuesve të tyre, rezultoi se kërkuesi Tom Dedaj nuk u paraqit në seancë, edhe pse kishte marrë njoftimin për zhvillimin e saj që më datë 22.06.2020.
26. Subjektet e interesuara, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Prokuroria e Përgjithshme, gjatë seancës gjyqësore publike, kërkuan zhvillimin e gjykimit në mungesë të kërkuesit Tom Dedaj.
27. Kolegji i Posaçëm i Apelit konstaton se kërkuesi Tom Dedaj, edhe pse ka pasur dijeni për shqyrtimin e çështjes në Kolegj, që prej kalimit të saj për kompetencë nga Gjykata e Apelit Administrativ, nuk ka paraqitur kërkesën apo parashtime me shkrim në lidhje me objektin e gjykimit dhe pretendimet e tij. Kërkuesi është njoftuar dhe ka marrë dijeni rregullisht për zhvillimin e seancës plenare publike, por nuk është paraqitur dhe nuk ka depozituar kërkesë për shtyrjen e seancës për ndonjë shkak të arsyeshëm. Kolegji, në vijim të situatës faktike si më sipër, çmon se kërkuesi, me mosparaqitjen, ka demonstruar mungesën e vullnetit të tij për t'ia nënshtruar gjykimin e kësaj çështjeje juridiksionit kushtetues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për pasojë ky vlerësim i parë lidhur edhe me mungesën e një akti formal drejtuar Kolegjit, i shpjeguar më lart se ka ndodhur për shkaqe të ndërvarura nga zgjedhjet procedurale të subjektit dhe vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ, e çon Kolegjin në përfundimin se situata faktike e përshkruar duhet të trajtohet si një heqje dorë nga kërkesa, në kuptim të parashikimit në nenit 31/b, pika 1 e ligjit nr. 8577/2000.
28. Duke vlerësuar çështjen në këtë mënyrë, në zbatim të nenit 31/b, pika 1 e ligjit nr. 8577/2000, i cili parashikon se: *Kërkuesi mund të heqë dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese vendos pushimin e gjykimit të çështjes*, Kolegji arrin në përfundimin se gjykimi i kësaj çështjeje pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit duhet të pushohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Posaçëm i Apelit i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/b, pika 1 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 99/2016,

VENDOSI:

Pushimin e gjykimit të çështjes nr. 1, datë 19.12.2019 të juridiksionit disiplinor, që i përket ankimit të z. Tom Dedaj kundër Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

Tiranë, më datë 20.07.2020.

KRYETARE

Natasha MULAJ
nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA
nënshkrimi

ANËTAR

Ardian HAJDARI
nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA
nënshkrimi

ANËTAR

Luan DACI
nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ
nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO
nënshkrimi